

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada- Government
Ministria e Financave dhe Transfereve
Ministarstvo za Finansije i Transfere – Ministry of Finance and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Budget Departament - Budget Departament

DATË	01.04.2019
REFERENCË	MF-22
PËR/ZA/TO:	Z. Enis Spahiu, Ushtrues Detyre i Sekretarit të Përgjithshëm, Ministria e Financave dhe Transfereve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministrja e Financave dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinioni i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për financimin e projektit për kadastër të patundshmërisë dhe Infrastrukturë gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Agjencionit Ndërkombëtar për Zhvillim

I nderuari z. Spahiu,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për financimin e projektit për kadastër të patundshmërisë dhe Infrastrukturë gjeo hapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Agjencionit Ndërkombëtar për Zhvillim, të paraqitur nga Ministria e Financave (në vijim MF-ja), formularin e vlerësimit të ndikimit buxhetor të përgatitur nga MF-ja, obligimin sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe nenin 19 të Ligjit Nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Departamenti i Buxhetit paraqet me sa vijon:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME NGA PROJEKTLIGJI

Ky projektligj ka për qëllim të ratifikoj Marrëveshjen për financimin e projektit për kadastër të patundshmërisë dhe Infrastrukturë gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Agjencionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Marrëveshja do të zbatohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, e cila do të fillon të realizohet nga viti 2020.

OPINIONI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB) TË PROJEKT LIGJIT NGA MINISTRIA PROPOZUESE

Ministria e Financave dhe Transfereve si organ propozues, ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të këtij projektligji dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet dhe planifikohet se ky projektligj për t'u zbatuar kushton 14,600,000 € për periudhën 2020-2023. Nga kostoja totale për zbatimin e këtij projektligji në Ligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 si dhe vlerësimet per vitet 2021 dhe 2022 është e planifikuar shuma prej 7,177,000 € e shpërndarë nëpër vite dhe kategori të shpenzimeve si vijon:

Vitet	2020	2021	2022
Mallra dhe Sherbime	100,000	100,000	100,000
Shpenzime kapitale	3,162,000	3,800,000	215,000
Totali	3,262,000	3,900,000	315,000

Ndërsa shuma prej 7,423,000 € do të përfshihet në planifikimet buxhetore për vitin 2023.
Për zbatimin e këtij projektligji shpenzimet operative do të akomodohen në kuadër të rregullës fiskale të deficitit 2% ndërsa projekti kapital do të financohen në kuadër të mekanizmit klauzola e investimeve.

Përfundim:

Ministria e Financave dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se aktivitete e parapara për zbatimin e Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për financimin e projektit për kadastër të patundshmërisë dhe Infrastrukturë gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Agjencionit Ndërkombëtar për Zhvillim për periudhën 2020-2022 në shumë prej €7,177,000 janë pjesë e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022 tek Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, ndërsa shuma prej 7,423,000 € do të përfshihet në projeksionet buxhetore për vitin 2023.
Shpenzimet kapitale të këtij projekti do të financohen përmes klauzolës se investimeve, ndërsa shpenzimet operative do të akomodohen në kuadër të rregullës fiskale të deficitit 2%.

Përgatitur nga:

Milaim Aliu, Udhëheqës i Divizionit të Buxhetit Qendror